



ne ofrojmë avantazh konkurrues, për t'i bërë investitorët të interesuar për të investuar në Shqipëri, por edhe duke i asistuar investitorët për të zhvilluar një interes në ata sektorë që qeveria shqiptare ka shpallur si prioritarë në zhvillimin e ekonomisë së vendit. "Mendoj se thelbi do të jetë informacioni i thelluar dhe i studiuar nga ana jonë, për të promovuar sa më mirë Shqipërinë, por edhe një orientim i tyre drejt investimit në sektorë ku jo vetëm do të kenë mundësinë të rrisin fitimet e tyre, por dhe të shtojnë vlerë për ekonominë shqiptare në formën e punësimit dhe rritjes së cilësisë së jetesës në vend",

KUSHTE TË REJA PËR INVESTITORËT

Flet Eneida Guria, drejtoresha e Agjencisë për Zhvillimin e Investimeve

Investimet e huaja direkte, por edhe ato vendase, prej vitesh janë vendosur në fokusin kryesor të qeverisë, e cila mori disa reforma për t'ia bërë punën më të lehtë. Por duket se ulja e taksave, reduktimi i licencave apo regjistrimi i biznesit nuk mjaftonin për t'i shtyrë edhe më shumë investitorët që t'i drejttoheshin Shqipërisë. Rezultatet edhe pse ishin pozitive, me rritje investimesh nga njëri vit në tjetrin, në raport me potencialet që ofronte vendi ynë, nuk ishin në nivelin e duhur. Krijimi i Agjencisë së Zhvillimit të Investimeve (AIDA), e cila ka nisur të funksionojë tani në janar të 2011-s, duket se do të ndryshojë terrenin shqiptar të të bërit biznes. Eneida Guria, drejtoresha e AIDA-s, tregon se, ligji i ri do të fokusohet në tre drejtime kryesore, krahas synimit për të shërbyer si pikë qendrore për të gjitha bizneset, qofshin ato vendase apo të huaja. "Më konkretisht tërheqjen e investimeve të huaja direkte, mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (SME) nëpërmjet rritjes së konkurrueshmërisë së tyre, si dhe mbështetjen dhe zhvillimin e eksporteve", shprehet ajo për "Monitor". AIDA është një agjenci tërësisht e re, edhe pse funksionet dhe objektivat e saj ngjasojnë me ato të agjencive paraardhëse, një aspekt shumë i rëndësishëm për t'u përmendur është dhe forma e organizimit të kësaj agjencie. Ajo drejtohet nga një Bord Drejtues, i cili ka në përbërje të tij pesë ministra, katër përfaqësues nga sektori privat dhe kryesohet nga Kryeministri. Sipas Gurias, përbërja e bordit drejtues në vetvete do të mundësojë dhe vëmendjen maksimale për agjencinë, si për sa i përket rolit të saj brenda vendit, ashtu edhe mundësisë për të ndërvepruar efektivisht me të gjitha institucionet qendrore dhe vendore në shërbim të investitorëve të huaj.



Politika e re për investimet

Plani i qeverisë për të zhvilluar investimet konsiston në një koordinim dhe asistim të projekteve, në mënyrë që të shkojnë aty ku duhet dhe që ka nevojë vendi ynë dhe në interes të investitorit. "Fillimisht, synimi është që kjo agjenci të jetë pika e parë dhe kryesore ku investitorët drejtohen si në fazën e interesimit për të investuar në vendin tonë, ashtu edhe gjatë fazës së konkretizimit të planeve të tyre për të investuar. Në fillim do të duhet një punë e mirë për të promovuar Shqipërinë si destinacion tërheqës për investime dhe më tej, agjencia do të synojë asistimin e investitorëve gjatë gjithë ciklit të investimit, duke ndërmjetësuar edhe me institucione të tjera qendrore apo vendore", thekson Guria. Sipas drejtoreshës së AIDA-s, një ndër objektivat e agjencisë është zhvillimi i strategjisë për tërheqjen dhe mbështetjen e investitorëve, prandaj është pak herët për të folur me detaje për këtë aspekt. Në thelb të kësaj strategjie do të qëndrojë promovimi i atyre sektorëve të ekonomisë shqiptare ku

tregon Guria, e cila më parë ka drejtuar Qendrën Kombëtare të Licencave, tjetër institucion i ngritur nga qeveria në kuadër të referimeve pro biznesit.

Sektorët kryesorë ku do të investohet

Sektorët prioritarë janë ata që qeveria prej kohësh i ka vendosur në fokus për sa i përket zhvillimit të vendit. "Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës është një ndër themelet e bërjes së Shqipërisë vend që konkurren denjësisht për tërheqjen e investimeve", thotë drejtoresha. Sipas saj, fokusi do të jetë tek ata sektorë ku Shqipëria ofron mundësi reale për investitorët, siç është sektori energjetik, agrobiznesi, sektori mineral dhe pa diskutim, turizmi. Këta sektorë jo vetëm janë pjesë e prioritetëve që qeveria ka shpallur, por e rëndësishme është se dhe vetë Shqipëria ka mundësi reale që të jetë destinacion investimesh. Ndër funksionet bazë të agjencisë është bashkëpunimi i vazhdueshëm me shoqatat e biznesit, si mjeti i duhur për arritjen e objektivave të kësaj agjencie. Fokusi i saj do të jetë te biznesi, si vendas dhe i huaj, pra do të jetë një agjenci në shërbim të biznesit dhe si e tillë do të ketë komunikim të vazhdueshëm me ta. ■

SQARIM

I nderuar lexues!
Në numrin e kaluar të revistës ka pasur një gabim teknik. Intervista: "AIDA, shansi i ri për investitorët që duan të rrisin fitimet", është dhënë nga zj. Eneida Guria dhe jo nga drejtori i Raiffeisen Bank, Christian Canacaris. I kërkojmë ndjesë lexuesit si dhe zj. Guria e z. Canacaris për këtë gabim teknik.